

SHPRESA ISMAJLI

NJËSI FRAZEOLGJIKE NGA RAJONI I LLAPIT

Frazeologjia gjuhësore përbën një pasuri të çmueshme e me vlera të shumta shprehëse- emocionale, e cila e gjallëron dhe e freskon gjuhën, e zhdërvjelltëson dhe e zbukuron komunikimin. Ndjenja e hollë e krijesit të madh ka krijuar shumë njësi të ndryshme frazeologjike, të cilat sjellin në gjuhë vlera të mëdha në përmbajtje e në ngjyrim emocionues, sjellin nuanca të holla kuptimesh e përdorimesh, gjykimin e popullit për gjërat e për njerëzit.¹ Veç vlerave gjuhësore, frazeologjia shpërfaq edhe psikologjinë e mendësinë e popullit, historinë e kulturën e tij.

Burim i lëndës është ligjërimi i folur popullor i trevës së Llapit, e cila është edhe vendlindja jonë. Treva e Llapit, e emërtuar sipas lumit Llap, shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës, në kufi me Serbinë. Shtrirja gjeografike periferike, ka bërë të mundur ruajtjen e shumë njësive leksikore, frazeologjizmave e shprehjeve të ngurtësuara të fjalëve etj., nxjerrja në pah e të cilave konsiderojmë se është e rëndësishme për pasurimin e gjuhës standarde. Njësitë frazeologjike që kemi vjelë nuk i kemi sjellë në trajtën normative apo përfaqësuese (si zë frazeologjik), por ashtu si i kemi gjetur në përdorim. Veç njësive frazeologjike të mirëfillta janë përfshirë edhe struktura të afërta me to ose me prirje drejt tyre, si disa urime e mallkime disa struktura të tipit fjali në trajta thëniesh të urta, sentencash, proverbash etj.

Përgjithësisht njësitë frazeologjike burojnë nga shndërrimi i figurshëm i togfjalëshave të lirë, të cilët duke u përsëritur vazhdimisht janë njësuar nga përmbajtja dhe janë ngurosur nga forma.² Kemi edhe njësi frazeologjike që nuk kanë togun e lirë gjegjësisht me kuptim të drejtpërdrejtë, që janë formuar në mënyra të ndryshme. Kuptimi i njësive frazeologjike në tërësi përcaktohet nga lidhja e brendshme figurative e kuptimit të njësive përbërëse të saj, gjithsesi njëra nga fjalët ka kuptim të figurshëm. Në rrafshin e përmbajtjes, njësitë frazeologjike kanë kuptimin e përgjithshëm kategorial të fjalëve, fjala dhe njësia frazeologjike kanë dallime nga kuptimi dhe nga ngjyrimi emocionues por nuk e mbulojnë përmbajtjen e njëra-tjetrës, njësia frazeologjike ka vlera më të shumta kuptimore dhe aftësi më të mëdha shprehëse e stilistike. Është e vështirë, pothuajse e pamundur që frazeologjitë të shpjegohen me të gjitha elementet semantike e mbishtrësore, kjo është edhe veçantia e tyre, arsyeja pse kanë lindur e përdoren në ligjërim.

¹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 203.

² Po aty.

Frazeologjizmat kanë karakter emërtues, d.m.th. shprehin nocione mbi sende, fenomene; cilësi sendesh; një veprim si proces; bashkime të qëndrueshme fjalësh që shprehin një cilësi a rrethanë të veprimit etj.

Njësitë frazeologjike që karakterizojnë negativisht njerëzit sipas tipareve të ndryshme fizike e morale janë të shumta dhe kanë përdorim të gjerë në rajonin tonë. “Përbërësi fizik” shpreh gjuhësisht një tipar të pamjes së jashtme të njeriut dhe “përbërësi moral” i referohet gjuhësisht një treguesi të karakterit, të temperamentit a të formimit të përgjithshëm të njeriut.³ Përgjithësisht këto frazeologji ndërtohen nga një gjymtyrë me kuptim të figurshëm dhe një me kuptim të drejtpërdrejtë, shumica prej tyre e karakterizojnë negativisht njeriun, përdoren për tallje, ironi, përçmim. Për të treguar **mendjetrashësinë** përdoren: *asht fushë Dumoshi, i ka shitë drutë, i ka hypë dhisë etj.*; **kokëfortësinë**: *e ka kryet çekiç, e ka kryet e çpum, e han hekrin me dham, koçitet si thi u n’akull*; **dembelinë**: *është shtat i pa fat, i man grushtat, i bjen kavallit*, **miqësinë**: *janë kam e krye; hanë me ni lugë*; **llafazanërinë**: *i ka shtatë guhë ni guhë; i pren gjuha*; **mendjemadhësinë**: *e ka menjen ku virren keptë*; **papjekurinë**: *e ka kryet gjog e met zog, u plak me një palë mend*; **pazotësinë**: *s’mundet me largu macën prej përsheshi, u met me thes krahve (ka mbetur pa asgjë)*; **hajdutërinë (vjedhjen)**: *e ka dorën, ban mjegull me kolicë*; **me kuptimin kurrë, asnjëherë përdoren**: *kur t’jet mazi plle, kur t’ban shelnja rrush, kur t’ban knusi vo etj.*

Në trevën tonë, numri më i madh njësive frazeologjike janë të motivuara nga togfjalëshat e lirë gjegjës. Frazeologjizmat e pamotivueshëm, lidhen me sende e dukuri të ndryshme të jetës, kanë dalë nga një anekdotë, një ndodhi a një ngjarje. Lidhjet ndërmjet kuptimit tërësor të njësisë dhe kuptimit të gjymtyrëve nuk janë të dukshme, prandaj është vështirë t’i shpjegojmë në gjendjen e sotme të gjuhës p.sh.: *e pa pykën e deli Ramës* (hoqi shumë vështirësi); *pshtoi si Rrusta* (shpëtoi shumë mirë); etj. Këtu hyjnë edhe ato njësi frazeologjike në përbërjen e të cilave ruhen fjalë, forma e kuptime të vjetruara, që përdoren vetëm brenda këtyre togjeve, me ruajtjen e të cilave është zbehur kuptimi i drejtpërdrejtë i togfjalëshave dhe është kristalizuar kuptimi figurshëm.⁴ P.sh.: *han për gaga* (han në kurriz të tjetrit, shfrytëzon tjetrin); *jet si pula n’shtyp* (punon ngathët); *e lyp me kokallë* (e lyp gjithandej); *u ba dubë* (është i gatshëm); *e ka kaceren nalt* (është mendjemadhe); *si n’shtata t’mretit* (si në mbretëri); *çite n’rogë t’livadhut* (qite në shesh); edhe ato frazeologjizma gjymtyrët e të cilave krijojnë rimë: *i ka lanë asht e rrasht* (ka punuar e është munduar shumë), *foli Zenës- foli stenës* (përdoret kur i flet dikujt e nuk ta vë veshin), *si dhia si taxhia* (si njëri si tjetri).

Përveç këtyre frazeologjive, ekzistojnë edhe njësi frazeologjike me vlerë fjalie: *e din ku bën dreçi vo* (keq. di vetëm punë të mbrapshta); *voja e kojshisë i duket ma e madhe* (lakmon gjithherë në gjërat e të tjerëve); *unë për lisa- ti për fshisa* (përdoret kur bashkëbiseduesi nuk të kupton fare); *e nxani me pelë për dore*

³ I. Metani, *Emërtime frazeologjike të njerëzve sipas dukës dhe sipas tipareve morale në gjuhën shqipe*, në “Gjurmime albanologjike”, 2014/44, f. 132.

⁴ Po aty.

Njësi frazeologjike nga rajoni i Llapit

(e zuri në flagrancë); *e shti dorën n'ujë t'valë* (garantoj); *rruj vo a hiqet lesh* (përdoret kur këshillon a qorton dikë e nuk të dëgjon fare), etj. Afërsisht të kësaj natyre janë edhe disa njësi frazeologjike në trajtën e fjalëve të urta ose të disa përgjigjeve tip; *borçlisë të keq- bishtin e sakicës* (borxhliut të keq merri çfarë të mundesh); *kur s'ka shi bën edhe breshën* (me kuptimin çdo ndihmë është e mirëseardhur, kur ke nevojë); *e ka kryet gjog e met zog* (është njeri i papjekur); *shnosh kryet se kapuçka ka boll* (përdoret me kuptimin shëndosh djali, në rastet kur ndahet ose vdes nusja; *çorba e lirë t'i sosë buzë-* përdoret kur mundohemi të kursejmë e shpenzojmë shumë më shumë etj.

Te tipi foljor i njësive frazeologjike në gjuhën shqipe merr pjesë, strukturalisht edhe kuptimisht, edhe mjeti gjuhësor i shprehjes së mohimit.⁵ Siç dihet ka njësi vetëm me trajtë e me kuptim pohues, vetëm me trajtë me kuptim mohues ose me trajtë e me kuptim edhe pohues edhe mohues. Te njësitë frazeologjike që kanë vetëm kuptim mohues, pjesëza mohuese është pjesë e domosdoshme e strukturës: *s'i rri kurrugu n'bark* (nuk di të mbajë sekrete); *nuk e hajnë as qetë* (nuk ka kurrfarë vlere, nuk shërben për asgjë); *s'munet me largu macën prej përsheshi* (është shumë i pazoti); *s'më ka guha lesh-* më hahet edhe mua, *s'i bjen guha n'gojë-* qan vazhdimisht, qan shumë; *s'ma kërkoi dhami (ushqimin)-* nuk pata mundësi as ta provoja; *s'ja ka rrxu çinat* – nuk i ka bërë asgjë, nuk e ka dëmtuar; *s'ja merr ne dorë-* nuk e pyet fare për asgjë; *s'ti jep ethe-* është koprrac i madh, etj. Me kuptim edhe pohues edhe mohues (me dhe pa pjesëzën mohuese) përdoren: *ta këput konopin/s'ta këput konopin-* (s')të ndihmon në vështirësi, *s'i shkon kunglli mi ujë gjithmonë / i ka shku kunglli mi ujë-* s'ecën mbarë gjithnjë / i ka ecur mbarë, etj.

Njësitë frazeologjike ndajfoljore formohen në mënyra të ndryshme:

- **me përsëritjen e së njëjtës fjalë:** *u ba zi e terr, as çen as langue-* as andej as kënde, etj.

- **me lidhëzën si:** *si maca nën tervësë* (me druajtje); *si dhia si taxhia* (si njëri si tjetri), *si n'bashqe t'babës* (lirisht, pa pyetur njeri), *si miza n'mjaltë* (me të gjitha të mirat), *si zog çure* (i lig, i dobët nga shëndeti) etj.

- **me parafjalën në, me:** *n'sy të hallkut-* sa për t'u dukur para tjerëve; *me krye nër gërrshanë* (në rrezik), etj.

Nëpërmjet këtij punimi kemi synuar të paraqesim një pjesë të thesarit të çmueshëm të frazeologjisë shqipe të këtij rajoni. Nga materiali i mbledhur shihet se kemi larmi frazeologjizmesh nga ndërtimi e nga mënyra e motivimit, me një semantikë të pasur me vlera të shumta shënjuese e shprehëse- emocionale.

BIBLIOGRAFI

A. Sula, *Fjalor fjalësh dhe shprehjesh popullore*, Tiranë, 2009.

A. Sula, *Larushia e fjalës në gojën e popullit*, Tiranë, 2013.

I. Metani, *Emërtime frazeologjike të njerëzve sipas dukës dhe sipas tipareve morale në gjuhën shqipe*, në “Gjurmime albanologjike”, 2014/44, f. 132.

⁵ J. Thomai, *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010.

- J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1981.
- J. Thomai, *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010.
- J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë 2006.
- M. Gjevari, *Frazeologji shqipe*. Prishtinë, 1968.
- M. Gjevari, *Frazeologjizma të gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1972.
- M. Ibrahim, *Trajtesa leksiko-frazeologjike të shqipes*, Shkup, 2015.
- Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, III*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1972.
- V. Memisha, *Rreth shndërrimit të togfjalëshit të lirë në njësi frazeologjike*, “Studime filologjike”, nr. 3-4, Tiranë, 2006.
- V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011.
- Z. Gjocaj, *Çështje të homonimisë e sinonimisë frazeologjike shqipe*, Prishtinë, 1998.
- Z. Gjocaj, *Çështje të strukturës leksiko-semanticke e stilistike të frazeologjisë shqipe*, Prishtinë 1994.
- Z. Gjocaj, *Struktura leksiko-semanticke e stilistike e frazeologjisë shqipe*, Prishtinë 2001.